



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 04.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **29.04.2022** të parashtruar nga Kompania e Pastrimit "AB Clean" NTSH, -Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale, me Nr. të Prok: 616-22-2998-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 035 211 nxjerr:

### VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Kompania e Pastrimit "AB Clean" NTSH, -Lipjan, të dt. 29.04.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale", me Nr. të Prok: : 616-22-2998-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 035 211, kundër Njoftimit për kontrate te AK-së, të datës 07.04.2022.

1. Vërtetohet Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues i dates 07.04.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale", me Nr. të Prok: 616-22-2998-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 035 211, sipas Njoftimit për kontrate te publikuar me datën: 07.04.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkruarit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Kompania e Pastrimit "AB Clean" NTSH, -Lipjan me datë 29.04.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale", me Nr. të Prok: 616-22-2998-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 035 211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.05.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:  
AK ka bere Njofimin per kontrate per kete aktivitetit te prokurimit gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat dhe Udhzuesin per Prokurimit Publik.

AK te gjitha kerkusat e kerkuara ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njofimin per kontrate te kerkusat mbi mundesite teknike dhe profesionale i ka bere shume te qarta dhe jo diskriminuese.  
AK ne sqarimet e dhena nga pyetja e nje OE, ka sqaruar dhe ka dhene informatat per 10 punetoret qe do te jete obligim nga OE, cili do qe propozohet per kontrate e qe do ti punesoje ata ose ato.

AK ka njohuri per 10 punetoret qe punojne ne Komunen e Prishtines, por nuk mund te kete njohuri per 40 punetoret qe do ti kete vete Operatori Ekonomik. Se a do ta paguaj pervojën e punes per katerdhjete punetoret tjere, Autoriteti Kontraktues per kete arsye ka kerkuar deklarate me shkrim nga ana e Operatoreve Ekonomik se:

**Kerkesa:**

OE duhet te deklarohet se punetoreve do tua paguaj pagën minimale bruto 250 euro si mbas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së duke përfshirë edhe pagesën e pervojës se punes per 10 punetoret nga lista e AK-se

**Deshmia:**

Deklarata e nenshkruar dhe vulosur nga OE se do te paguaj Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, Pushimet vjetore, - Kontributet ne paga, dhe tatimet tjera , fitimin i OE, - TVSH-ja dhe Totalin e ofertës. (qe nenkupton qe duhet paguar te gjitha taksat dhe tatimet e aplikuar ne kosove përfshirë te gjithë punetoret nga ana e OE dhe 10 punetoret nga Autoriteti Kontraktues)

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit